



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILI I MINISTRAVE

PROJEKTVENDIM

Nr. __, datë __. __. 2019

**PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETEVE KOMPETENTE DHE PROCEDURËS QË
DO TË NDIQET, PËR PËRMBUSHJEN E DETYRIMEVE TË CAKTUARA NGA
GJYKATA PËR TË MITURIN NË KONFLIKT ME LIGJIN**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 102 të pikës 3 të ligjit nr. 37/2017, datë 30.03.2017 “Kodi i Drejtësisë Penale për të mitur”, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

**KREU I
RREGULLA TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1
Objekti**

1. Ky vendim përcakton autoritetet kompetente dhe procedurën që ndiqet prej tyre në rastet kur gjykata urdhëron të miturin në konflikt me ligjin të përmbushë një nga detyrimet e caktuara në përputhje me nenin 120 të ligjit nr. 37/2017, datë 30.03.2017 “Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur”.
2. Qëllimi i përmbushjes së detyrimeve të caktuara në pikën 1 të këtij neni është rishoqërizimi, riintegrimi, rehabilitimi dhe parandalimi i rikryerjes së veprës penale ose i kryerjes së një vepre tjetër penale, duke i ofruar të miturit kujdes, asistencë dhe mbikëqyrje.

**Neni 2
Zbatimi i procedurës**

Autoritet e caktuara në këtë vendim dhe procedura që do të ndiqet prej tyre janë të njëjta pavarësisht nëse ‘përmbushja e detyrimeve të caktuara’ jepet si dënim plotësues ose si dënim jo me burgim.

**KREU II
AUTORITETET KOMPETENTE**

**Neni 3
Autoritetet kompetente në nivel qendror**

1. Autoritet kompetent është organi ose institucioni shtetëror, strukturat në nivel qendror dhe vendor, që brenda fushës së veprimtarisë, sipas vendimit të gjykatës, ndjek përmbushjen e detyrimeve të caktuara ndaj të miturit në konflikt me ligjin.
2. Autoriteti kompetent caktohet nga gjykata varësisht natyrës së detyrimit që duhet përmbushur

3. Autoritetet qendrore përgjegjëse për zbatimin e këtij vendimi janë:
- i) Ministria e Drejtësisë,
 - ii) Ministria përgjegjëse për çështjet e arsimit;
 - iii) Ministria përgjegjëse për çështjet e punësimit;
 - iv) Ministria përgjegjëse për çështjet e shëndetit dhe mbrojtjes sociale;
 - v) Ministria e Brendshme.
4. Zbatimi i detyrimeve të caktuara nga gjykata ndaj të miturit në konflikt me ligjin kërkon sigurimin e një bashkëpunimi efektiv ndërmjet strukturave dhe autoriteteve qendrore e vendore, si dhe organizatave që mbrojnë të drejtat e fëmijës.

Neni 4

Autoritetet kompetente në nivel vendor

1. Drejtuesi i strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore dhe drejtuesi i njësisë së mbrojtjes së fëmijës pranë organeve të vetëqeverisjes vendore përgatit dhe përditëson listat e autoriteteve kompetente dhe personave përgjegjës dhe ia dërgon ato strukturave vendore të Policisë së Shtetit, Prokurorisë dhe seksionit/gjykatës përkatës.
2. Kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes së personave përgjegjës janë të njëjta me ato të përfaqësuesve proceduralë të përcaktuar me udhëzim të përbashkët të ministrit që bashkërendon punën për çështjet e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës dhe Ministrit të Drejtësisë sipas ligjit për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës.
3. Autoritete përgjegjëse në rastin e vendimit të gjykatës që i mituri në konflikt me ligjin të ndjekë arsimin e detyrueshëm ose, sipas rastit, një program mësimor janë:
 - i) drejtuesi i njësisë përkatëse arsimore vendore;
 - ii) drejtori i institucionit arsimor publik;
 - iii) mësuesi përgjegjës.
4. Autoritetet përgjegjëse në zbatim të vendimit të gjykatës, që i mituri në konflikt me ligjin të ndjekë një program të formimit profesional, sipas ligjit për arsimin profesional janë:
 - i) drejtuesit e programeve mësimore dhe të formimit profesional (AFP)
 - ii) përfaqësuesi i njësisë arsimore vendore (drejtorisë rajonale/zyrës arsimore), që mbulon institucionin arsimor publik, ofrues të AFP-së (shkollat publike profesionale);
 - iii) përfaqësuesi i zyrës rajonale/vendore të punësimit, që mbulon institucionin arsimor publik, ofrues të AFP-së;
 - iv) përfaqësuesi i personelit mësimdhënës të institucionit publik, ofrues të AFP-së;
5. Autoriteti përgjegjës në zbatim të vendimit të gjykatës, që i mituri në konflikt me ligjin të përmbushë detyrimet që rrjedhin nga marrëdhënia e punës e siguruar nga programet sociale të punësimit është drejtuesi i zyrës rajonale ose vendore të punësimit të Shërbimit Kombëtar të Punësimit
6. Autoritetet përgjegjëse në zbatim të vendimit të gjykatës, që i mituri në konflikt me ligjin të ndjek një program rehabilitues të trajtimit psikologjik ose mjekësor, përfshirë, sipas rastit, trajtimin detoksifikues nga përdorimi i alkoolit ose drogës janë:
 - i) shërbimet e shëndetit mendor për fëmijët dhe të rinjtë në nivel vendor ose qendror;
 - ii) drejtoritë/institucionet e kujdesit të shëndetit (specialistët e shëndetit, mjekët e spitaleve, mjeku i familjes);
 - iii) strukturat e mbrojtjes së fëmijës në njësinë e qeverisjes vendore ;
 - iv) Drejtoritë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror;
 - v) Urdhri i Psikologut.
7. Autoritet përgjegjëse në zbatim të vendimit të gjykatës, që i mituri në konflikt me ligjin të mos frekuentojë vende të caktuara dhe shoqërohet me persona të caktuar janë:
 - i) shërbimi i provës,
 - ii) strukturat e Policisë së Shtetit,
 - iii) ofruesit publikë dhe privatë të shërbimeve për fëmijët,
 - iv) mësuesit,

Neni 5
Bashkëpunimi i autoriteteve kompetente

1. Në rast se përmbushja e detyrimit të caktuar nga gjykata përfshin më shumë se dy autoritete kompetente, plani individual parashikon protokollet e komunikimit midis tyre dhe të bashkërendimit të veprimtarisë.
2. Autoritetet kompetente bashkëpunojnë me shoqërinë civile dhe organizatat jofitimprurëse që ofrojnë shërbime në fushën e të drejtave të të miturve.

Neni 6
Marrëdhëniet e autoriteteve me prokurorinë dhe gjykatën

1. Nëse vendimi i prokurorisë apo gjykatës parashikon detyrimin periodik për raportim, drejtori i strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore në bashkëpunim me autoritetin përgjegjës lidhur me detyrimin e caktuar nga gjykata, përcakton në planin individual personin përgjegjës që mban marrëdhëniet me gjykatën.
2. Në rastin e zbatimit të pikës 1 të këtij neni, personi përgjegjës, përgatit një raport me shkrim dhe, nëse çmohet e nevojshme nga prokuroria apo gjykata, mund të pyetet për ecurinë e përmbushjes së detyrimit të caktuar dhe marrjen e masave konkrete rast pas rasti.
3. Raporti sipas pikës 2 të këtij neni mbështetet në të dhënat e marra nga autoritetet e përcaktuara dhe të përfshira në realizimin e planit individual në varësi të detyrimit të caktuar me vendim të prokurorisë apo gjykatës.

KREU III
PROCEDURA PËR ZBATIMIN E VENDIMIT TË GJYKATËS PËR
PËRMBUSHJEN E NJË DETYRIMI TË KAKTUAR

Neni 7
Hartimi i planit individual për të miturit në konflikt me ligjin

1. Procedura për zbatimin e vendimit të gjykatë për përmbushjen e një detyrimi të caktuar përcaktohet në planin individual.
2. Drejtuesi i strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore në nivel vendor dhe autoritetet përgjegjëse të caktuara në vendimin e gjykatës janë kompetente dhe përgjegjëse për miratimin e planit individual për të miturit në konflikt me ligjin për përmbushjen e detyrimit të caktuar nga gjykata për të miturin në konflikt me ligjin.
3. Drejtuesi i strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore në nivel vendor dhe autoritetet ose autoriteti kompetent i caktuar nga gjykata për përmbushjen e detyrimit në bashkëpunim me grupin teknik ndërsektorial, që funksionon në nivel bashkie ose pranë njësisë administrative të bashkisë, jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë nga marrja e këtij vendimi, marrin masa për të lehtësuar dhe mbështetur zbatimin e planit individual për të miturin konkret për realizimin e vendimit të gjykatës për përmbushjen e detyrimit/eve të caktuara.
4. Në hartimin e planit individual për të miturin në konflikt me ligjin punonjësi për mbrojtjen e fëmijës ndjek parimet, garancitë dhe të drejtat e parashikuara në legjisllacionin në fuqi për të drejtat e fëmijëve.
5. Në hartimin e planit individual për të miturin në konflikt me ligjin për përmbushjen e detyrimit të caktuar merret në konsideratë:
 - i) moshë e të miturit,
 - ii) gjendja mendore dhe emocionale,
 - iii) nevojat e veçanta,
 - iv) mënyra e jetesës dhe nevojat e tij, veçanërisht ato të lidhura me familjen,
 - v) edukimi ose puna,

- vii) qëndrimi pas kryerjes së veprës penale, si dhe
 - viii) rrethana të tjera, që ndikojnë në vendosjen e detyrimeve, dhe mbikëqyrjen e tyre.
6. Për hartimin e planit individual për të miturin në konflikt me ligjin merret mendimi i të miturit dhe sigurohet pjesëmarrja e tij sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi, si dhe mendimi i prindit të të miturit në konflikt me ligjin.
 7. Në hartimin e planit individual për të miturin në konflikt me ligjin mbahet në vëmendje kohëzgjatje e përmbushjes së detyrimit të caktuar në vendimin e gjykatës. Në asnjë rast kjo kohëzgjatje nuk mund të kalojë kufijtë e caktuara në vendimin gjyqësor.
 8. Format i planit individual për të miturin në konflikt me ligjin, miratohet me urdhër të ministrit të Drejtësisë.

Neni 8

Parime mbi trajtimin e të miturit gjatë zbatimit të planit individual

1. Gjatë zbatimit të planit individual për të miturin në konflikt me ligjin sipas detyrimit të caktuar nga gjykata, i mituri trajtohet me dinjitet nga çdo individ dhe autoritet si dhe informohet për të drejtat e tij dhe mjetet e ushtrimit të tyre.
2. Ndalohet çdo lloj dhune dhe ndëshkimi të të miturit si masë korrigjuese për përmbushjen e detyrimit të caktuar nga gjykata.
3. Të gjithë autoritet sipas këtij vendimi kanë për detyrë të mbrojnë të dhënat personale sipas detyrimeve që përcaktohen në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.
4. Autoriteti kompetent dhe personi përgjegjës marrin masa për ruajtjen e konfidencialitetit të të miturit ndaj të tretëve.
5. Të miturit i garantohet ndihma ligjore dhe psikologjike falas, në përputhje me interesat, zhvillimin dhe aftësitë e fëmijës.

Neni 9

Monitorimi/inspektimi i zbatimit të planit individual për të miturin në konflikt me ligjin

1. Monitorimi/inspektimi i rregullt i punës së autoriteteve sipas këtij vendimi kryhet nga strukturat kompetente sipas natyrës së masës së caktuar.
2. Drejtuesi i strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore në nivel vendor cakton punonjës in për mbrojtjen e fëmijës si përgjegjës për marrjen e masave për monitorimin e zbatimit të Planit Individual dhe të respektimit të të drejtave të të miturit.
3. Vëmendje e veçantë gjatë monitorimit i kushtohet përdorimit të forcës, kufizimeve, dënimeve disiplinore dhe formave të tjera të trajtimit të të miturit.
4. Në procesin e monitorimit mund të marrin pjesë edhe organizata që mbulojnë çështjet e drejtësisë për të miturit.

Neni 10

Njoftimi i planit individual për të miturin në konflikt me ligjin

1. I mituri, prindërit, përfaqësuesit ligjor i të mitur marrin një kopje të planit individual brenda 24 (njëzet e katër) orëve nga miratimi i tij.
2. Plani individual për të miturin në konflikt me ligjin përmban pasojat në rast të moszbatimit të tij dhe mënyrat e njoftimit të të miturit, prindërve dhe autoriteteve rast pas rasti.
3. Një kopje e planit individual depozitohet në gjykatë.

Neni 11

Përmbajtja e përgjithshme e planit individual

1. Plani individual për të miturin në konflikt me ligjin përmban por jo vetëm:

- duke u kujdesur që kjo të jetë e njëjtë me vendbanimin e të miturit ose sa më pranë këtij;
- ii) aktivitetet konkrete të të miturit për përmbushjen e detyrimit të caktuar nga gjykata;
 - iii) të drejtat e të miturit në konflikt me ligjin me qëllim përmbushjen e detyrimit të caktuar;
 - iv) masa të tjera të veçanta me qëllim përmbushjen e detyrimit të caktuar nga gjykata të tilla si:
 - a. këshillim psikologjik,
 - b. kurse për menaxhimin e zemërimit,
 - c. trajtim të shëndetit mendor,
 - ç. mbështetje e familjes për regjistrimin në gjendje civile,
 - d. mbështetje për përfshirje në skemën e ndihmës ekonomike,
 - dh. mbështetje për përfshirje në shërbimet e punësimit,
 - e. mbështetje për përfshirje në shërbimet shëndetësore, si dhe
 - ë. çdo ndërhyrje tjetër.
 - v) kohëzgjatjen e planit individual duke caktuar datën e fillimit dhe të mbarimit
 - vi) komunikimin dhe njoftimet gjatë zbatimit të planit individual;
 - vii) rregulla lidhur me ndryshimin e planit individual
 - viii) pasojat e moszbatimit ose të shmangies nga zbatimi i planit individual
 - ix) bashkëpunimin institucional dhe ndarjen e përgjegjësive
 - x) bashkëpunimin me shoqërinë civile
 - xi) të drejtën e ankimit
 - xii) përfundimi i përmbushjes së detyrimit të caktuar
2. Plani individual për të miturin në konflikt me ligjin, sipas rastit, mund të përmbajë masa për mbështetjen e të miturit në çdo ndërhyrje që do të përmirësonte situatën familjare dhe rolin e familjes dhe do të garantonte mbrojtjen e fëmijës brenda saj.
 3. Plani individual për të miturin në konflikt me ligjin përfshin të dhënat dhe kontaktet e personin përgjegjës për ndjekjen e zbatimit të tij, si dhe të drejtat dhe detyrat e tij.
 4. Plani individual për të miturin në konflikt me ligjin hartohet në 3 kopje origjinale, të cilat i vihen në dispozicion të miturit/përfaqësuesit ligjor, organit kompetent dhe personit përgjegjës, duke shënuar datën e miratimit dhe të përfundimit të tij.
 5. Plani individual për të miturin në konflikt me ligjin nënshkruhet nga i mituri dhe personi përgjegjës.

Neni 12

Masat e menjëhershme

1. Në rast se i mituri nuk përmbush detyrimin/et e caktuara nga gjykata në përputhje me planin individual për të miturin në konflikt me ligjin, personi përgjegjës sipas pikës 3 të nenit 11 të këtij vendimi njofton menjëherë të miturin, prindin, përfaqësuesin ligjor me qëllim marrjen e masave konkrete dhe zgjidhjen e rastit.
2. Në raste se i mituri me gjithë masat e marra sipas pikës 1 të këtij nenin nuk përmbush detyrimin e caktuar nga gjykata, personi përgjegjës vë në dijeni drejtuesin e zyrës së shërbimeve sociale pranë njësive vendore dhe punonjësën e Njesisë për Mbrojtjen e fëmijëve të cilët marrin masa të menjëhershme, sipas legjislacionit në fuqi.
3. Në raste se i mitur nuk zbaton planin individual për të miturin në konflikt me ligjin, autoriteti kompetent, punonjësi i zyrës së shërbimeve sociale pranë njësive vendore dhe punonjësi i Njesisë për Mbrojtjen e fëmijëve marrin masa për të njoftuar në mënyrë të menjëhershme gjykatën.

Neni 13

Veçoritë e përmbushjes së detyrimit për ndjekjen e arsimit të detyrueshëm ose një programin mësimor

individual për të miturin në konflikt me ligjin mban në vëmendje:

- i) nevojat e veçanta/individuale për fëmijën që nuk arrin rezultatet e pritshme që synon programi mësimor i një klase të caktuar, me qëllim integrimin e tyre në sistemin e edukimit;
 - ii) përfshirjen në programet mësimore që do të ndiqen nga i mituri dhe prindërit duke i zhvilluar këto në bashkëpunim me të miturin dhe prindin;
 - iii) masat konkrete për ofrimin e shërbimeve sociale dhe psikologjike brenda mjediseve të shkollës
 - iv) masat me qëllim parandalimin e largimit nga shkolla para kohe të fëmijës;
 - v) masat e tjera lidhur me ushqimin, pajisjen me libra dhe mjete didaktike, transport e të tjera, me qëllim parandalimin e braktisjes së shkollës për arsye ekonomike;
 - vi) personin përgjegjës që do të mbikëqyrë zbatimin e vendimit të gjykatës brenda mjediseve shkollore dhe njëherazi që do të kujdeset për parandalimin, trajtimin brenda shkollës dhe raportimin tek autoritetet përgjegjëse të situatave të dhunës, duke përfshirë edhe ato ndërmjet vetë fëmijës brenda shkollës (bulizmi);
 - vii) personin përgjegjës që do të mbikëqyrë të drejtën e fëmijës për t'u çlodhur, si dhe të drejtën për të marrë pjesë në aktivitete kulturore e artistike;
 - viii) detyrat e veçanta të mësuesve që japin mësim në këto klase lidhur me mbajtjen e dokumentacionit, raportimin e mbarëvajtjes, institucionin/personin ku bëhet raportimi dhe periodicitetin raportimit;
 - ix) rolin e prindërve ose kujdestarëve ligjorë të të miturit.
2. Autoriteti kompetent mund të marrë të masa të tjera për përmbushjen e detyrimit të caktuar nga gjykata duke u bazuar në ligjin për arsimin parauniversitar si dhe legjislacionin për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës dhe aktet nënligjore në bazë dhe për zbatim të tyre.

Neni 14

Veçoritë e përmbushjes së detyrimit për ndjekjen e një programi të formimit profesional, sipas ligjit për arsimin profesional

1. Autoriteti kompetent veç parashikimeve të përgjithshme, gjatë hartimit dhe zbatimit të planit individual për të miturin në konflikt me ligjin mban në vëmendje:
- i) programet e formimit profesional zhvillohen në përputhje me legjislacionin në fuqi mbi arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë;
 - ii) pajisen e të miturit me çertifikatën përkatëse pas përfundimit të kurseve/programeve profesionale të ofruara nga këto institucione.

Neni 15

Veçoritë e përmbushjes së detyrimeve që rrjedhin nga marrëdhënia e punës e siguruar nga programet sociale të punësimit

1. Autoriteti kompetent veç parashikimeve të përgjithshme, gjatë hartimit dhe zbatimit të planit individual për të miturin në konflikt me ligjin në zbatim të këtij detyrimi mban në vëmendje se:
- i) ndalohet marrja në punë e fëmijës nën moshën 16 vjeç.
 - ii) fëmija mund të kryejë punë të lehta, që nuk dëmtojnë shëndetin, formimin e tij ose e largojnë atë nga shkolla, sipas përcaktimeve të parashikuara në Kodin e Punës.
 - iii) i gjithë dokumentacioni në lidhje me marrëdhëniet e punës plotësohet me ndihmë dhe këshillimin ligjor përkatës.
2. Autoritetet përgjegjëse veprojnë në përputhje me dispozitat e Kodit të Punës dhe legjislacionit në fuqi për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës.

Neni 16

Veçoritë e riparimit të dëmit civil

individual për të miturin në konflikt me ligjin në zbatim të këtij detyrimi mban në vëmendje:

- i) mundësitë ekonomike të të miturit dhe të prindërve të tij;
- ii) mënyrën e reagimit të të miturit pas kryerjes së dëmit dhe marrjen e masave prej tij për të minimizuar pasojat e dëmit;
- iii) gatishmërinë e të miturit për të kompensuar dëmin përmes dëmshpërblimit në të holla ose në natyrë përmes kryerjes së një shërbimi, veprimi, pune, ose aktivitete të tjera kompensuese;
- iv) aftësitë për kryerjen e detyrave të veçanta;
- v) mënyrën dhe mjetet e riparimit të dëmit civil.

Neni 17

Veçoritë e përmbushjes së detyrimit për ndjekjen e një programi rehabilitues të trajtimit psikologjik ose mjekësor, përfshirë, sipas rastit, trajtimin detoksifikues nga përdorimi i alkoolit ose drogës

1. Autoritet përgjegjëse në ndjekjen e një program rehabilitues të trajtimit psikologjik ose mjekësor, përfshirë, sipas rastit, trajtimin detoksifikues nga përdorimi i alkoolit ose drogës përfshijnë në veprimtarinë e tyre dhe planin individual për të miturin në konflikt me ligjin:

- i) përgatitjen e një raporti në lidhje me gjendjen e të miturit në momentin e mbërritjes në institucion si edhe ecurisë së tij deri në përfundim të programit rehabilitues.
- ii) ndjekjen e një programi/plani rehabilitues të trajtimit psikologjik ose mjekësor, përfshirë sipas rastit trajtimin detoksifikues nga përdorimi i alkoolit ose drogës të kombinuar me
 - a. këshillim;
 - b. punë grupi;
 - c. terapi;
 - ç. kurset me natyrë psikologjike për menaxhimin e inatit, nervozizmit, dhe të gjendjeve të tjera agresive;
 - d. plan të aktiviteteve kulturore/sportive;
 - dh. plan të aktiviteteve integruese/formuese/argëtuese.

Neni 18

Veçoritë e përmbushjes së detyrimit për mos frekuentuar vende të caktuara dhe për të mos u shoqëruar me persona të caktuar, të cilët mund të ndikojnë negativisht në sjelljen dhe edukimin e tij

1. Autoriteti kompetent veç parashikimeve të përgjithshme, gjatë hartimit dhe zbatimit të planit individual për të miturin në konflikt me ligjin në përmbushjen e këtij detyrimi mban në vëmendje:

- i) që të përfshijë shpjegime dhe këshillim të herëpashershëm të të miturit lidhur me sjellje që ndikojnë negativisht në edukimin e tij;
- ii) përcaktimin e vendeve që nuk duhet të frekuentohen nga i mituri;
- iii) një listë të personave me të cilët i mituri nuk duhet shoqëruar;
- iv) bashkëpunimin e ngushtë me familjen, shkollën dhe shoqërinë civile veçanërisht në mbikëqyrjen nga ana tyre të përdorimit të mjeteve të teknologjisë së informacionit dhe informacionit të transmetuar në rrugë elektronike.

Neni 19

Dispozitë e përgjithshme

Ngarkohet Ministria e Drejtësisë, Ministria përgjegjëse për çështjet e arsimit; Ministria përgjegjëse për çështjet e punësisimit; Ministria përgjegjëse për çështjet e shëndetit dhe mbrojtjes sociale për fëmijët, Ministria e Brendshme dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Hyrja në fuqi

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1 Janar 2019.

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

RELACION

PËR PROJEKTVENDIMIN “PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETEVE KOMPETENTE DHE PROCEDURËS QË DO TË NDIQET, PËR PËRMBUSHJEN E DETYRIMEVE TË CAKTUARA NGA GJYKATA PËR TË MITURIN NË KONFLIKT ME LIGJIN ”

I. QËLLIMI I PROJEKTVENDIMIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Projektvendimi propozohet në zbatim të ligjit nr. 37/2017, datë 30.03.2017 “Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur”, duke plotësuar legjislacionin në fuqi në lidhje me autoritetet kompetente dhe procedurën që ndiqet prej tyre në rastet kur gjykata urdhëron të miturin në konflikt me ligjin të përmbushë një nga detyrimet e caktuara me vendim gjykate.

Projektvendimi synon të qartësojë përmbushjen e detyrimeve të caktuara nga gjykata duke mbajtur në konsideratë që autoritetet sipas këtij vendimi të mbajnë në vëmendje se standarde me rëndësi janë rishoqërimi, riintegrimi, rehabilitimi dhe parandalimi i rikryerjes së veprës penale ose i kryerjes së një vepre tjetër penale prej të miturit në konflikt me ligjin penal, duke i ofruar të miturit kujdes, asistencë dhe mbikëqyrje. Objektivi i këtij projektvendimi është sigurimi i një liste të plotë të organeve në nivel qendror dhe vendor, si dhe përcaktimi i procedurës që do të ndiqet nga ana e tyre në rast të vendimit të gjykatës në rastin kur kjo e fundit ka ngarkuar të miturin me përmbushjen e një nga detyrimet e caktuara sipas parashikimeve të KDPM.

Projektvendimi unifikon procedurën që do të ndiqet prej autoriteteve të caktuara në vendimin e gjykatës. Kjo procedurë është e njëjta pavarësisht nëse ‘përmbushja e detyrimeve të caktuara’ jepet si dënim plotësues ose si dënim jo me burgim.

II. VLERËSIMI I PROJEKTVENDIMIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Relacion për projektvendimin e Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e autoriteteve kompetente dhe procedurës që do të ndiqet, për përmbushjen e detyrimeve të caktuara nga gjykata për të miturin në konflikt me ligjin”

Ky projektvendim nuk përfshihet në programin politik të Këshillit të Ministrave. Projektvendimi është hartuar në bazë dhe si detyrim i vendosur për Këshillin e

Ministrave nga përcaktimet të nenit 102 pika 3 dhe nenit 141 pika 1 të ligjit nr. 37/2017, datë 30.03.2017 “Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur”.

Projektvendimi është më përputhje me zbatimin e objektivave të parashikuara në programin e qeverisë për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve dhe hartohet në përputhje me strategjinë kombëtare për zhvillim dhe integrim 2015-2020 në të cilin theksohet nevoja për të ngritur një sistem të veçantë të drejtësisë për të miturit, që sjell legjislacionin ekzistues në përputhje me standardet ndërkombëtare.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTVENDIMIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Projektvendimi përcakton autoritetet kompetente në nivel qendror dhe vendor, si dhe procedurën në rastin e një vendimi gjykatë për përmbushjen e një detyrimi prej të miturit në konflikt me ligjin sipas tekstit që i bashkëlidhet dhe që është pjesë përbërëse e këtij projektvendimi.

Ky projektvendim zbatohet plotësisht në të gjithë fushën e sipërpërmendur me qëllim sigurimin e mbrojtjes sa më të plotë të të drejtave dhe trajtimin e të miturve në konflikt me ligjin penal dhe synon plotësimin e detyrimit kushtetues për garantimin e të drejtës së fëmijëve për mbrojtje të veçantë nga shteti. Duke parashikuar autoritetet konkrete dhe procedurën për realizimin e vendimit të gjykatës bëhet realitet mbrojtja me efikasitet e të drejtave të fëmijëve në konflikt me ligjin. Ky projektvendim sjell një qasje tjetër ndaj mënyrës se si konceptohen të drejtat e fëmijës, dhe se cilat janë masat konkrete që duhet të merren nga strukturat përgjegjëse për të parandaluar, rehabilituar ose mbrojtur në vazhdimësi fëmijën ndërkohë që zbatohet vendimi i gjykatës.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektvendimi është hartuar në mbështetje të Kushtetutës dhe legjislacionit në fuqi, duke garantuar që çdo fëmijë të jetë i mbrojtur nga dhuna, keqtrajtimi, shfrytëzimi ekonomik dhe puna e detyruar ose jo nën moshën minimale të lejuar nga legjislacioni, duke dëmtuar shëndetin, moralin ose të rrezikojë jetën dhe zhvillimin e tij normal.

Projektvendimi plotëson detyrimin kushtetues që përcakton detyrimin e shtetit për mbrojtje të veçantë ndaj fëmijëve, sipas nenit 54 të Kushtetutës. Projektvendimi propozohet në zbatim të ligjit nr. 37/2017, datë 30.03.2017 “Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur” konkretisht të nenit 102 të pikës 3 dhe mbështetet në standardet ndërkombëtare pjesë e instrumenteve ndërkombëtare të ratifikuara nga Shqipëria.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)

Ky projektvendim nuk lidhet me çështjet e përafrimit të legjislacionit me *acquis communautaire*.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTVENDIMIT

Projektvendimi përcakton autoritetet kompetente dhe procedurën që ndiqet prej tyre në rastet kur gjykata urdhëron të miturin në konflikt me ligjin që të përmbushë një nga detyrimet e caktuara prej saj sipas dispozitave të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur. Për qartësi për çdo autoritet, projektvendimi përcakton detyrimet që mund të jepen nga ana e gjykatës. Nenin 1 i projektvendimit rendit detyrimet sipas përcaktimeve të Kodit me qëllim orientimin e organeve kompetente që të kuptojnë se kush bën çfarë, siç detajohet edhe në vijim të përmbajtjes së tij. Pavarësisht veçorive të çdo detyrimi të caktuar ndaj të miturit, ajo që mbetet me rëndësi si për gjykatën edhe për autoritetin konkret është garantimi i qëllimit të përmbushjes së detyrimeve të

Relacion për projektvendimin e Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e autoriteteve kompetente dhe procedurës që do të ndiqet, për përmbushjen e detyrimeve të caktuara nga gjykata për të miturin në konflikt me ligjin”

caktuara të tillë si: rishoqërizimi, riintegrimi, rehabilitimi dhe parandalimi i rikryerjes së veprës penale ose i kryerjes së një vepre tjetër penale, duke i ofruar të miturit kujdes, asistencë dhe mbikëqyrje.

Projektvendimi unifikon procedurën duke e bërë këtë të thjeshtë dhe të njëjtë për çdo organ pavarësisht diversitetit të detyrimit të caktuar.

Projektvendimi në nenet 3 dhe 4 bën një renditje të autoriteteve kompetente në dy nivele: qendror dhe vendor. Fjala kyç e projektvendimit është bashkëpunimi efektiv ndërmjet tyre dhe me gjykatën, si edhe me organizatat që mbrojnë të drejtat e fëmijës, sikurse parashikohet në nenet 5 dhe 6 të tij. Në nivel qendror autoritetet kryesore/qendrore përgjegjëse për zbatimin e vendimit të gjykatës janë: Ministria e Drejtësisë, Ministria përgjegjëse për çështjet e arsimit; Ministria përgjegjëse për çështjet e punësimit; Ministria përgjegjëse për çështjet e shëndetit; Ministria e brendshme; Njësitë e vetëqeverisjes vendore. Autoritetet kompetente në nivel vendor nuk janë një listë shteruese, pasi ato lidhen pikërisht me natyrën e përmbushjes së detyrimit. Strukturat në nivel vendor të Policisë së Shtetit, Prokurorisë dhe gjykata përditësohen me listat e organeve ligjzbatuese dhe të personave përgjegjës. Projektakti përcakton detyrimin që ky informacion të përmbushet nga drejtuesi i strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore dhe drejtuesi i njësisë së mbrojtjes së fëmijës pranë organeve të vetëqeverisjes vendore në bashkëpunim me autoritetet kompetente. Projektvendimi përcakton autoritetet përgjegjëse sipas fushës së detyrimit të caktuar në rastin e urdhërit të gjykatës që i mituri në konflikt me ligjin penal. Kështu, nëse detyrimi ka të bëjë me ndjekjen e arsimit të detyrueshëm ose, sipas rastit, të një program arsimimi autoriteti konkret është: drejtuesi i njësisë përkatëse arsimore vendore; drejtori i institucionit arsimor publik; mësuesi përgjegjës. Nëse detyrimi është që i mituri në konflikt me ligjin penal të ndjekë një program të formimit profesional, sipas ligjit për arsimin profesional, përgjegjës janë: drejtuesit e ofruesit të shërbimeve të arsimit dhe të formimit profesional (AFP) përfaqësuesi i njësisë arsimore vendore (drejtorisë rajonale/zyrës arsimore), që mbulon institucionin arsimor publik, ofrues të AFP-së (shkollat publike profesionale); përfaqësuesi i zyrës rajonale/vendore të punësimit, që mbulon institucionin arsimor publik, ofrues të AFP-së; përfaqësuesi i personelit mësimdhënës të institucionit publik, ofrues të AFP-së. Me këto funksione janë gjithashtu, sipas llojit të detyrimit kur ky lidhet me marrëdhënie të punës: drejtuesi i zyrës rajonale ose vendore të punësimit të

Shërbimit Kombëtar të Punësimit. Projekt akti përcakton autoritetet përgjegjëse në rastet kur i mituri duhet të ndjek një program rehabilitues të trajtimit psikologjik ose mjekësor, përfshirë, sipas rastit, trajtimin detoksifikues nga përdorimi i alkoolit ose drogës të tillë si: shërbimet e shëndetit mendor për fëmijët dhe adoleshentët në nivel vendor ose qendror; drejtoritë/institucionet e kujdesit të shëndetit (specialistët e shëndetit, mjeku i familjes); strukturat e mbrojtjes së fëmijës në njësinë e qeverisjes vendore; Urdhri i Psikologut dhe drejtoritë rajonale të Shërbimit Social Shtetëror. Në rastet kur vendimi i gjykatës përcakton se i mituri në konflikt me ligjin penal të mos frekuentojë vende të caktuara dhe shoqërohet me persona të caktuar, autoritetet janë: shërbimi i provës, strukturat e Policisë së Shtetit, ofruesit e shërbimeve për fëmijë, publikë dhe privatë, mësuesit, prindërit ose kujdestarët e të miturit.

Një rëndësi të veçantë ka neni 6 i projektvendimit në të cilin përcaktohet komunikimi dhe marrëdhënia e autoritetit me gjykatën. Në nenet 7-18 projektvendimi detajon procedurën për zbatimin e urdhërimit të gjykatës për përmbushjen e një detyrimi të caktuar duke përcaktuar rregulla të përgjithshme për çdo autoritet për detyrimin për hartimin e planit individual dhe rregulla të veçantë për përpilimin e tij sipas veçorive të detyrimit konkret pa anashkaluar garancitë dhe të drejtat e parashikuara në legjislacionin në fuqi për të drejtat e fëmijëve dhe ato të nenit 8 të projektvendimit, si dhe mendimin e të miturit sipas parimeve të pjesëmarrjes si dhe mendimi i prindit të të miturit në konflikt me ligjin penal. Planet janë individuale dhe në përshtatje me nevojat dhe kërkesat e të miturve. Në hartimin e planit individual mbahet në vëmendje kohëzgjatje e përmbushjes së detyrimit të caktuar në vendimin e gjykatës. Në asnjë rast kjo kohëzgjatje nuk mund të kalojë kufijtë e caktuara në vendimin gjyqësor.

Një aspekt me rëndësi është monitorimi/mbikëqyrja e veprimtarisë së autoriteteve dhe që gjen rregullim në këtë akt duke e bërë kështu procesin dinamik dhe që mund të përmirësohet hap pas hapi.

Projektvendimi jep rëndësi rregullave mbi njoftimin e planit individual si germa e parë e transparencës dhe zbatimit të tij. Për të lehtësuar autoritetet kompetente projekt akti ka një listë të aspekteve që përbëjnë përmbajtjen e planit individual dhe të masave të menjëhershme në rast moszbatimi të tij varësisht nëse kjo ndodh prej të miturit ose pengohet. Projekt akti bën një paraqitje të veçorive që

Relacion për projektvendimin e Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e autoriteteve kompetente dhe procedurës që do të ndiqet, për përmbushjen e detyrimeve të caktuara nga gjykata për të miturin në konflikt me ligjin"

paraqet çdo detyrim i caktuar ndaj të miturit në vendimin e gjykatës. Në këtë mënyrë respektohen parimet e unitetit dhe të diversitetit të përmbajtjes së planit individual rast pas rasti.

VII. MINISTRITË, INSTITUCIONET DHE SUBJEKTET E TJERA QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTVENDIMIT

Projektvendimi është hartuar nga Ministria Drejtësisë, në bashkëpunim me ekspertë të UNICEF dhe TLAS “Shërbimi Ligjor Falas, Tiranë”. Projektvendimi i është nënshtruar një procesi konsultimi paraprak me institucionet ligjzbatuese dhe shoqërinë civile. Projektvendimi ka qenë objekt diskutimi i tryezës së rrumbullakët të zhvilluar nga Ministria e Drejtësisë në bashkëpunim me UNICEF dhe TLAS të organizuar në datën 8 Maj 2018, në Tiranë, me temë “Për konsultimin e projektvendimeve nënligjore të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur”. Një tjetër, tryezë e rrumbullakët për diskutimin e paketës nënligjore të hartuar në zbatim të Kodit është zhvilluar më datë 29 Maj 2018, në rrethin e Kurbinit.

Në zbatim të ligjit Nr. 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”, projektvendimi është hedhur në website-in për konsultim publik në datën 19.06.2018, me qëllim marrjen e mendimeve apo sugjerime nga ana e institucioneve apo grupet e interesit.

Pas kalimit të afatit ligjorë 20 (njëzet) ditor nga publikimi i tyre të përcaktuar në ligj, nuk u përcoll asnjë koment mbi përmbajtjen apo fushën e veprimit të projektvendimit dhe relacionit shoqëruar nga ana e institucioneve apo grupet e interesit. Nga verifikimi i kryer në datë 06.12.2018, nuk rezulton të ketë komente në këtë regjistër për këtë projekt akt.

Ministria e Drejtësisë ka përcjellë projektvendimin për konsultim nëpërmjet sistemit e-aktet, drejt Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Në vijim të kërkesës për mendim të Ministrisë së Drejtësisë, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nëpërmjet sistemit e-aktet dhe shkresës me

nr. 6765 prot., datë 26.11.2018, ka përcjellë qëndrimin e saj duke u shprehur si më poshtë vijon:

“Në nenin 3, pika 3, nënpika iv, sugjerojmë të riformulohet në përputhje me fushën e përgjegjësisë shtetërore:

‘iv. ministria përgjegjëse për çështjet e shëndetit dhe mbrojtjes sociale’.

Në nenin 4, pika 6,

- nënpika ii) pas shprehjes “...specialistët e shëndetit..”, mendojmë të shtohet “...mjekët e spitaleve..”.

- nënpika 4, togfjalëshi “..Drejtoritë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror”, të bëhet nënpikë v), për arsye se Urdhri i Psikologut është ent publik i pavarur.

Për nenin 7 “Plani individual” mendojmë se procedurat që janë përcaktuar për tu ndjekur në këtë projektvendim janë të ngjashme, por nuk janë të njëjta me VKM nr. 578, datë 03.10.2018, “Për procedurat e referimit dhe të menaxhimit të rastit, hartimit të planit individual të mbrojtjes, financimin e shpenzimeve, për zbatimin e tij, si edhe zbatimin e masave të mbrojtjes”. Propozojmë që ky të quhet Plani Individual për Fëmijët në konflikt me ligjin. Ky projektvendim të përcaktojë procedurën për zbatimin e këtij plani. Sugjerojmë që bashkëlidhur këtij projektvendimi të ketë një formular të veçantë, për hartimin e këtij plani, i ngjashëm me formularët e VKM Nr. 578/2018.

Në nenin 8, pika 5, të riformulohet:

“v. Të miturit i garantohet ndihma ligjore dhe psikologjike falas, në përputhje me interesat, zhvillimin dhe aftësitë e fëmijës”.

Në nenin 9, pika 4 mendojmë se duhet të përcaktohen institucionet kompetente lidhur me “organizmat vendase”, si edhe roli që kanë dhe cilët janë në këtë rast “organizmat e huaj”.

Në nenin 10, pika 3 mendojmë që togfjalëshi “pranë strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore në nivel vendor”, të hiqet pasi kjo strukturë është përgjegjëse për hartimin dhe miratimin e këtij plani.

Në nenin 12, pika 1, shprehja “sipas pikës 3 të nenit 11 të këtij projektvendimi”, të saktësohet renditja në nenin 11, pasi nuk ka pikë 3 në nenit 11.”

Nga ana e Ministrisë së Drejtësisë, janë shqyrtuar të gjitha komentet e mësipërme, duke bërë reflektimet e nevojshme në përmbajtje të projektvendimit.

Ndërkohë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë nuk ka përcjellë ende mendim, ndaj edhe në përputhje me parashikimet e pikës 28 të vendimit nr. 584/2003 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullores së Këshillit të Ministrave", të ndryshuar, ku përcaktohet se pas mbarimit të afatit 10 ditor, kur mendimi i kërkuar nuk është dhënë, do të konsiderohet se ministri përkatës është dakord dhe pa vërejtje për projektaktin, Ministria e Drejtësisë ngarkohet me detyrimin e përcjelljes së projektvendimit për shqyrtim dhe miratim pranë Këshillit të Ministrave.

VIII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Organet që ngarkohen me zbatimin e këtij projektvendimi janë Ministria e Drejtësisë, Ministria përgjegjëse për çështjet e arsimit; Ministria përgjegjëse për çështjet e punësimit; Ministria përgjegjëse për çështjet e shëndetit; Ministria e brendshme; Njësitë e vetëqeverisjes vendore, si dhe strukturat në nivel vendor në varësi të këtyre institucioneve qendrore.

Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur parashikon në nenin 140 pika 6 se brenda datës 1 janar 2019 fillojnë të zbatohen dhe hyjnë në fuqi dispozitat që lidhen me veprimtarinë e institucioneve dhe autoriteteve kompetente që kujdesen për përmbushjen e detyrimeve nga të miturit, sipas nenit 102, pika 3, të tij.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Ky projektvendim nuk parashikon të ketë efekte financiare shtesë pasi përfshihet brenda planifikimeve buxhetore të strukturave që ushtrojnë veprimtarinë në fushat e përkatëse.

MINISTRI I DREJTËSISË

Etilda Gjonaj (Saliu)

Relacion për projektvendimin e Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e autoriteteve kompetente dhe procedurës që do të ndiqet, për përmbushjen e detyrimeve të caktuara nga gjykata për të miturin në konflikt me ligjin"